



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
SENATI AKADEMIK

Nr. 1051 / Prot.
3

Tiranë, më 19/05 /2020

VENDIM
Nr. 45, datë 19.05.2020

PËR
PEZULLIMIN E PROCESIT TË APLIKIMEVE PËR ANËTARË SENATI AKADEMIK,
REKTOR, DREJTUES I NJËSIVE KRYESORE DHE DREJTUES I NJËSIVE BAZË, NË
ZGJEDHJET E AUTORITETEVE DHE ORGANEVE DREJTUESE NË
UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË

Në bazë të nenit 3 e vijues si dhe nenit 131 të ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencorë në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Urdhërit të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 8, datë 14.01.2020 “Për procesin zgjedhor për autoritete... “ i ndryshuar, Urdhërit të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr.108, datë 08.05.2020 “Për shtyrjen e datës së zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë për shkak të gjendjes së fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga pandemia e COVID – 19”, si dhe sipas diskutimeve në mbledhje, Senati Akademik,

VENDOSI:

1. Të pezullojë procesin e aplikimeve për anëtarë Senati Akademik, Rektor, Drejtues të Njësive Kryesore, Drejtues të Njësive Bazë në zgjedhjet e autoriteteve dhe organeve drejtuese në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, deri në marrjen e një sqarimi juridik nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për këtë çështje.
2. T’i kërkohet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë sqarim juridik mbi realizimin e aplikimeve për autoritete dhe organe drejtuese në UMT-së, në zbatim të Urdhërit nr.108, datë 08.05.2020 “Për shtyrjen e datës së zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë...”, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi, Komisioni Institucional Zgjedhor i UMT-së, si dhe të gjitha strukturat e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
PROF. DR. ARBEN GJATA

